



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1280/5 prot.

Tiranë më 26.10.2017

VENDIM

Nr. 94, datë 26.10.2017

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “**Commercee Corp**” Sh.p.k (SHOP TV).

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 250 datë 02.10.2017 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit “Commercee Corp” Sh.p.k (SHOP TV)” mbajtës i nr. NUIS (L11518009H) me objekt:

- Verifikimi i ankesës të paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga një qytetar, në kuadër të verifikimit të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua se:

1. Kontrolluesi “Commercee Corp” Sh.p.k (SHOP TV) ushtron aktivitet tregtar për shitje direkte të produkteve të ndryshme. Kontrolluesi realizon marketing të drejtpërdrejtë ndaj subjekteve të të dhënave nëpërmjet programit të komunikimit “VICIdial”. Në programin “VICIdial” regjistrohen numrat e telefonit për thirrjet dalëse të realizuara nga operatorët e kontrolluesit. Programi mundëson regjistrimin zanor të telefonatave, si dhe ruan rekorde (log-e) me numrat e subjekteve të të dhënave, kohëzgjatjen e bisedës, datën dhe orën kur janë kontaktuar nga operatorët e kontrolluesit.
2. Në lidhje me ankesën e paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga personi me iniciale L. Gj, në kuadër të respektimit të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale, në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, u krye kërkimi i rekordit për numrin e ankuesit

përmes opsionit të kërkimit në ndërfaqen e administrimit të programit "VICIdial". Gjithsej rezultuan dy thirrje drejt këtij numri në datat 12.09.2017, me kohëzgjatje 5 sekonda dhe 19.09.2017 me kohëzgjatje 28 sekonda dhe status NI (jo i interesuar).

3. Kontrolluesi "Commercee Corp" Sh.p.k (SHOP TV) nuk është në gjendje që të provojë marrjen e pëlqimit për të kontaktuar ankuesin në numrin e tij të celularit, sipas nenit 3 pika 24 e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, duke vepruar në kundërshtim me nenin 6 pika 1/a e këtij ligji.

Në përfundim të kontrollit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin (datë 12.10.2017), si dhe në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", në datën 23.10.2017, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit, është mbajtur seanca dëgjimore me përfaqësuesin e kontrolluesit, lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ.

Përfaqësuesi i kontrolluesit gjatë seancës dëgjimore parashtrroi këto pretendime lidhur me konstatimet e grupit të inspektimit:

*"Sistemi "VICIdial" i gjeneron numrat e celularit në mënyrë matematikore dhe në këtë fazë këto numra janë të dhëna anonime të cilat nuk kanë asnjë lidhje me një subjekt të identifikuar apo të identifikueshëm".*

Pavarësisht qëndrimit të përfaqësuesit të kontrolluesit, Zyra e Komisionerit vlerëson se të dhënat e përpunuara nga kontrolluesi janë të dhëna personale sipas parashikimit të pikës 1 të nenit 3, të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar i cili cilëson si të dhënë personale çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social.

Pika 12 e po këtij neni parashikon se *"Përpunim i të dhënave personale" është çdo veprim ose grup veprimesh, të cilat janë kryer mbi të dhënat personale, me mjete automatike ose jo, të tilla si mbledhja, regjistrimi, organizimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, rikthimi, konsultimi, shfrytëzimi, transmetimi, shpërndarja ose ndryshe duke vënë në dispozicion, shtrirja ose kombinimi, fotografimi, pasqyrimi, hedhja, plotësimi, seleksionimi, bllokimi, asgjësimi ose shkatërrimi, edhe në qoftë se nuk janë të regjistruara në një bankë të dhënash.*

Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit vlerëson se përpunimi i të dhënave personale (numër telefoni dhe tinguj, siç është regjistrimi vokal që sistemi i bën thirrjes) mund ta bëjë lehtësisht të identifikueshëm subjektin e të dhënave nëpërmjet përdorimit të këtyre faktorëve të veçantë të identitetit të tij fizik.

Referuar pretendimeve dhe dokumenteve të paraqitura si provë nga kontrolluesi, Zyra e Komisionerit vlerëson se ky lloj përpunimi, pavarësisht mënyrës së gjenerimit të numrave të telefonit, nuk është në përputhje me frymën e ligjit, pasi nuk garanton zbatimin e nenit 6 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, duke mos legjitimuar përpunimin e të dhënave personale të subjekteve të të dhënave të cilët nuk kanë dhënë pëlqimin paraprak për t’u kontaktuar.

Në nenin 3 pika 24 e ligjit, përcaktohet kuptimi i “pëlqimit” të subjekteve të të dhënave sipas të cilit: “Pëlqim i subjekteve të të dhënave është çdo deklaratë me shkrim, e dhënë shprehimisht me vullnet të plotë e të lirë dhe duke qenë në dijeni të plotë për arsyen pse të dhënat do të përpunohen, çka nënkupton që subjekti i të dhënave pranon që të përpunohen të dhënat e tij”.

Për sa kohë kontrolluesi nuk ka mundur të provojë ekzistencën e pëlqimit të ankuesit për përpunimin e të dhënave të tij, vlerësojmë se përpunimi i të dhënave është i paligjshëm, duke cënuar edhe parimin e sanksionuar në nenin 5/1/a të ligjit.

Për më tepër, tek kontrolluesi është ushtruar më parë (në zbatim të Urdhrit nr. 159, datë 24.06.2016) një hetim administrativ pas të cilit Komisioneri ka dalë me Rekomandimin nr. 17, datë 29.07.2016. Pjesë e detyrimeve të lëna në këtë rekomandim, rezultojnë të jetë dhe marrja e pëlqimit paraprak për të gjithë subjektet e të dhënave, të dhënat e të cilëve përpunohen për qëllim marketingu të drejtpërdrejtë, detyrim i cili nuk ishte plotësuar dhe rezultojnë përsëri shkelje gjatë hetimit administrativ.

Si përfundim, shkelja e konstatuar gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39/1 shkronja “a”, e Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, përbën kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me gjobë, si më poshtë:

*a) kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II “Përpunimi i të dhënave personale”, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;*

Kontrolluesi “Commercee Corp” Sh.p.k (SHOP TV), në formën ligjore të aktivitetit të tij tregtar është person juridik dhe sipas nenit 39/2 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkelja e konstatuar është serioze, ajo lidhet me garantimin e përpunimit të ligjshëm të të dhënave nëpërmjet marrjes së pëlqimit të subjekteve për përpunimin e të dhënave të tyre. Gjithashtu, bazohet dhe në moszbatimin e rekomandimit të mëparshëm të Zyrës së Komisionerit.

## PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 6/1/a, 29, 30, 31, 39/1/a, 39/2, 40 dhe 41 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

### V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit "Commercee Corp" Sh.p.k (SHOP TV) me gjobë, në vlerën 40 000 (dyzet mijë) lekë për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 6 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
2. Kontrolluesi "Commercee Corp" Sh.p.k (SHOP TV), në zbatim të nenit 6/1/a të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të ketë në vëmendje përmbushjen në vazhdim të detyrimit për marrjen e pëlqimit paraprak për të gjithë subjektet e të dhënave, të dhënat e të cilëve përpunohen prej tij në cilësinë e kontrolluesit me qëllim realizimin e marketingut.
3. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 26.10.2017

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

